



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje
të Përhershme**

Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturore, Peizazh kulturor

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Kështjella antike e Keqekollës

Fotografi pamje karakteristike, dt...



Data/t kryesore të themelimit të asetit : shek. IV - VI

Periudhat /historike: antikitetit i vonë

Adresa,Qyteti/Fshati, Keqekollë ,Komuna e Prishtinës

Lloji i asetit të propozuar

(Kategoria ligjore dhe Nënkatëoria sipas nenit 2 të LTK)

Kategoria : Trashëgimi Arkeologjike

Nënkatëoria : lokalitet arkeologjik

Numri i inventarit (unik) 003682

Numri i regjistrimit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/ referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Akti i mëhershëm nëse ka

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Të përkthyer nga arsyetimi se përse asetit i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.

Kështjella e Keqekollës përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, arkitekturore, inxhinierie dhe kulturore për komunën e Prishtinës dhe për rajonin. Ngrihet mbi një kodër me pozitë të jashtëzakonshme strategjike, 864 m mbi nivelin e detit. Ajo në të gjitha anët është fortifikuar me mure të ngritura me gurë mesatar dhe të vegjël të lidhur me llaç të bardhë gëlqereje. Kështjella në anën jugore mbrohet me një kullë drejtkëndore, të ngritur në tri faza. Lartësia e mureve të kullës së fazës së parë të ndërtimit nga ana e brendshme është 4.20 m pa arritur në taban, ndërsa nga ana e jashtme muret deri në taban ruhen në lartësinë prej 4.70 m.

Muret rrethuese në te dyja anët e kullës janë zbuluar në gjatësi 15 m, muri perëndimor, dhe 10 m muri lindor, ndërsa lartësia e tyre është zbuluar prej lartësisë 0.60 deri në lartësinë 2m. Në anën veriore të kullës është zbuluar hyrja e kullës së fazës së parë sikurse edhe një parë shkallare guri të përbëra prej 8 shkallësh. Në anën perëndimore të kështjellës, përafërsisht në mesin e saj është zbuluar hyrja kryesore dhe një hyrje anësore në anën verilindore. Hyrja kryesore, hyrja për karroca është e gjere 3.20 m.

Kështjella është ngritur në shek. IV - VI pas Krishtit, duke mos përjashtuar mundësinë e përfaqësimit të fazave dardane të epokës parahistorike të bronzit dhe të hekurit, sikurse edhe fazat mesjetare të shek. IX – XI pas Krishtit. Mund të identifikohet me kështjellën Kekola, të cilën e përmend Prokopi i Cezaresë, historiani i oborrit mbretëror të mbretit më origjinë dardane Justinianit, në veprën “Mbi ndërtimet”, në shek. VI pas Krishtit.

Kështjella brenda bedenave përfshinë sipërfaqe prej afro 0.60 hektar.

Në anën jugore, aty kodra ka një pozitë më pak të favorshme për mbrojtje, kundruall anëve të tjera janë hapur në një largësi 7 – 10 m, tri hendeqe, gjatësia e të cilave është afro 50 m. Ka të ngjarë që këto hendeqe të jenë hapur në epokën parahistorike të hekurit. Se bashku me muret rrethuese dhe hendeqet kështjella arrin sipërfaqe prej 1 hektari.

Përgjatë anës perëndimore të kështjellës në gjatësi prej 1.5 km ndiqet traseja e rrugës antike e shtruar me kalldrëm. Gjatësia e rrugës është 1.5km, kurse gjerësia 2m.

Krite ret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nent 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlera arkeologjike : Përfaqësimi i shtresimeve arkeologjike, arkitektura, gjetjet arkeologjike, janë dëshmi për zhvillimin e jetesës, kulturës gjatë antikitetit të vonë të shekujve IV – VI, pa përjashtuar mundësinë e përfaqësimit të shtresave parahistorike dhe të mesjetës së vonë të shek. VII – XI

Vlerat artistike : Kështjella e Keqekollës më tërësinë arkitekturore, origjinalitetin e ruajtur të mureve rrethuese, kullës veriore, hyrjes për karroca hyrjes për këmbësor, objekteve të banimit, raportet e zgjidhjeve estetike arkitekturale në mes tyre, sikurse edhe teknikat e murimit ofron dëshmi të vlerave artistike të një stili të veçantë arkitektural të shek. IV – VI.

Vlerat shkencore : Gjetjet arkeologjike të kështjellës së Keqekollës, qeramika, objektet metalike, sistemi i fortifikimit, objektet e banimit, objektet e kultit, ofrojnë vlera të mëdha shkencore për njohjen e periudhës së antikitetit të vonë.

Vlerat shoqërore: Karshi vlerave arkeologjike, artistike, shkencore, kështjella e Keqekollës ka vlera të mëdha shoqërore ngase këtu janë zhvilluar traditat kulturore gjatë antikitetit të

vonë. Kështjella e cila njihet me emërtimet *Gjytet* dhe *Kala* vazhdon të jetë pikë referimi për popullatën e fshatit dhe të trevës

Vlerat shpirtërore: Kështjella e Keqekollës është simbol i identitetit të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullatës dardane gjatë shekujve shek. IV-VI .

Rariteti : Kështjella e Keqekollës është unike në rajon për mënyrën e fortifikimit dhe zgjidhjet inxhinerike.

Propozuesi:

Institucioni: [Instituti Arkeologjik i Kosovës](#)

Emri/ Mbiemri: [Enver Rexha](#)

Nënshkrimi

Adresa dhe kontakt: [Rruga Nazim Gafurri, p.n. 10000 Prishtinë](#)

Email : enverrexha@gmail.com

Mob. [044 115 423](#)

Data : .../.../.....

***Bashkangjitur:*Lista e të dhënave dhe dokumentacioni**

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Mbrojtja dhe menaxhimi i asetit/Masat juridike dhe teknike
6. Monitorimi
7. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokollit .../.../... Dt.../.../.....


Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit



Shtojcë1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Komuna e Prishtinës, fshati Keqekollë

Fshati Keqekollë ndodhet rreth 22km në verilindje të Prishtinës në malësinë e Gallapit, pranë rrugës antike, mesjetare dhe bashkëkohore që lidhte Kosovën me Leskocin. Keqekolla ka trashëguar vlera të trashëgimisë kulturore që nga epoka e bronzit të vonë në vijuesi deri në periudhën mesjetare. Lokalitetet më të rëndësishme janë nekropoli dhe vendbanimi dardan bronzit të vonë (shek. XIII – XI p. Kr.) dhe gjurmët e kishës mesjetare në afërsi të vendit të quajtur Kroni i Gjytetit.

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëizim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Kështjella malore e Keqekollës ndodhet në perëndim të fshatit, në vendin e quajtur me dy emra, Gjytet dhe Kala. Rrethohet nga një ambient kodrinor dhe malor. Kështjella në verilindje

kufizohet me rrugën ndër malore që lidh terrenin malor e kodrinor me fshatin Keqekollë. Në anët jugore dhe lindore kufizohet me ledhet e jashtme të mureve rrethuese. Në veri kufizohet më ledhin nr. 3 të hendekut mbrojtës. Ndërsa në perëndim kufizohet më trasenë e rrugës antike.

Perimeter i asetit të propozuar: 1 ha

Zonë rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: 7 ha

Sipërfaqja totale: 8 ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit meshenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese
 $P=1:500$ dhe $1:200$.
- Planet kadastral të asetit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rrethit, shfrytëzuesit/pronarë dhe përdorimi i tokës.
- Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rrethit (buffer zone), gjeoreferencat në min tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rrethit të paraqiten në formë vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratografinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- Përshkrimi i asetit të propozuar ngamomenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.
- Një rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël apo lokalitetet) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës/strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit,

stiliarkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimidheaspektetjeterandërlidhësetëlokacionittëaseti, siçjanëtereni, oborri, mobiljet, pikturat, mbishkrimet, mjedisirrehtij, etj.

- *Nërastet e qyteteveosetënjëkuartihistorik, tëbëhetpërshkrimi i ndërtesavehistorikekryesoretëkarakteritpublikdheplani i bazëssësipërfaqësperimetraletëasetitit me përshkrimin e mjedisitrrethues.*
- *Ndërlidhur me lokalitetetetaporeservatetarkeologjikedheartinshkëmbor, tëbëhetpërshkrimi i peizazhitmjedisor. Ndërsa, peizazhikulturortëpërshkruhetnjetësinërastet e lartëshënuara, duke përqëndruarvëmendjennëspecifikat e interakcionithistorikndërmjetnatyrësddenjeriut.*

Kështjellae Keqekollësështë monument i antikitetit tëvonëtëshekujve IV – VI pas Krishtit. Përfshinësipërfaqeprej 1 hektari. Ngrihej mbi një kodër me pozitë të jashtëzakonshme strategjike, 864 m mbi nivelin e detit. Ajo në të gjitha anët është fortifikuar me mure të ngritura me gurë mesatar dhe të vegjël të lidhur më llaç të bardhë gëlqereje. Muret rrethuese të trasha rreth 1.80 – 2.00 m ruhen mirë në të gjitha anët. Ato ndjekin linjën më të lartë të izohipsës së kodrës duke i dhënë kështjellës trajtën e drejtkëndëshit të çrregullt. Kështjella në anën jugore mbrohej më një kullë drejtkëndore me permasa 9.45 x 7 m.

Në anën perëndimore të kështjellës, përafërsisht në mesin e saj, ndodhet hyrja kryesore, hyrja për karroca është e gjere 3.20 m. Kurse në verilindje të kështjellës ndodhej një hyrje tjetër me dimensione 1.5 x 0.80m

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që kështjella është ngritur në shek. IV, ndërsa është rindërtuar gjatë shek. VI pas Krishtit, duke mos përjashtuar mundësinë e përfaqësimit të fazave dardane te epokës parahistorike të bronzit dhe të hekurit, sikurse edhe fazat mesjetare të shek. IX – XI pas Krishtit. Kështjella mund të identifikohet me kështjellën Kekola, të cilën e përmend Prokopi i Cezaresë, historiani i oborrit mbretëror të mbretit më origjinë dardane Justinianit, në veprën “ Mbi ndërtimet”, në shek. VI pas Krishtit.

Shtojcë 3: Dokumentacioniteknik i gjendjesaktuale tëndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturavekryesoretëasetit tëpropozuar përmbrojtje, në P= 1:200,

përfshirplanimetritdheprerjetkryesore, fasadatkarakteristike, aksonometria (mundësisht), dhefotografikarakteristiketëenterieritdheeksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Funksioni aktual : Kështjella nuk shfrytëzohet.

Pronësia: Kështjella është në pronësi të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Ndërsa menaxhohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, si institucion kompetent për menaxhimin e trashëgimisë arkeologjike në territorin e Kosovës.

Shfrytëzuesi aktual : Gjatë viteve 2006, 2007 - 2008 janë kryer gërmime arkeologjike. Kurse në vitin 2013 konservime. Shfrytëzohet vetëm për nevoja të Institutit Arkeologjik të Kosovës, për gjurmime dhe konservime.

Zhvillimi historik i asetit

- *Përshkrimi i formësimit të asetit ngathemeliminëgjendjenaktuale, duke specifikuarndryshimet, transformimet, demolimetapörindërtimetdomethënësenëhistorinë e konservimit.*
- *Ndërlidhur me asetet e trashëgimisëarkitekturoredhearkeologjike, tëbëhetparaqitja e fazavekryesorendërtimorepërmonumente, ansambledhelokalitete. Peizazhikulturor, tëpërshkruhet sipastëdhënavetë lartëshënuara, duke përfshirëaspektin e historisësëaktivitetevenjerëzorenëmjedisinnatyror.*

Funkcionet :

Kështjella e antikitetit ngrihej mbi një kodër me pozitë të jashtëzakonshme strategjike, 864 m mbi nivelin e detit. Ajo në të gjitha anët është fortifikuar me mure të ngritura me gurë mesatar dhe të vegjël të lidhur me llaç të bardhë gëlqereje. Muret rrethuese të trasha rreth 1.80 – 2.00 m ruhen mirë në të gjitha anët. Ato ndjekin linjën më të lartë të izohipsës së kodrës duke i dhënë kështjellës trajtën e drejtkëndëshit të çrregullt. Kështjella në anën jugore mbrohej me një kullë drejtkëndore, të ngritur në tri faza, Kulla e faza së parë është me përmasa 9.45 x 7 m. Në fazën e parë kulla lidhet në mënyrë organike me muret rrethuese.

Kurse brenda kullës së fazës së parë, në një fazën e dytë ngritët edhe një kullë tjetër 6 x 4 m, ndërsa në fazën e tretë murit ballor të kullës së fazës së parë i shtohen edhe dy mure të tjera, të cilat së bashku me këtë mur formojnë një kullë në trajtë trekëndëshi, fenomene këto të pa para deri me tani në kështjellat e Dardanisë.

Lartësia e mureve të kullës së fazës së parë të ndërtimit nga ana e brendshme është 4.20 m pa arritur në taban, ndërsa nga ana e jashtme muret deri në taban ruhen në lartësinë prej 4.70 m.

Muret rrethuese në tll dyja anët e kullës i janë zbuluar në gjatësi 15 m, muri perëndimor, dhe 10 m muri lindor, ndërsa lartësia e tyre është zbuluar prej lartësisë 0.60 deri në lartësinë 2m.

Në anën veriore të kullës është zbuluar hyrja e kullës së fazës së parë sikurse edhe një parë shkallare guri të përbëra prej 8 shkallësh. Në anën perëndimore të kështjellës, përafisht në mesin e saj është zbuluar hyrja kryesore dhe një hyrje anësore në anën verilindore. Hyrja kryesore, hyrja për karroca është e gjere 3.20 m. Hyrja ruhet deri në lartësinë 1.30 m, kurse muri veriore ruhet deri në lartësinë më të madhe prej 1m. DysHEMEJA e hyrjës është shtruar me kalldrëm të bërë nga gurët e thyer vendor. Hyrja anësore e zbuluar pjesërisht është e gjerë rreth 1.20 m.

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që kështjella është ngritur në shek. IV, ndërsa është rindërtuar gjatë shek. VI pas Krishtit, duke mos përjashtuar mundësinë e përfaqësimit të fazave dardane të epokës parahistorike të bronzit dhe të hekurit, sikurse edhe fazat mesjetare të shek. IX – XI pas Krishtit. Jemi të mendimit që kështjella mund të identifikohet me kështjellën Kekola, të cilën e përmend Prokopi i Cezaresë, historiani i oborrit mbretëror të mbretit më origjinë dardane Justinianit, në veprën “Mbi ndërtimet”, në shek. VI pas Krishtit.

Transformimet Ndërhyrjet konservuese: Ndërhyrje konservuese të pjesëshme janë ndërmarrë në vitin 2013 në kullën veriore. Kështjella është e rrezikuar nga shkatërrimi në mungesë të ndërhyrjeve konservuese. Të rrezikuara janë kulla veriore, hyrja për karroca, hyrja për këmbësorë, muret rrethuese në lindje dhe në perëndim të kullës veriore dhe dy objektet e banimit në qendër të kështjellës.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet aseti, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza komparative e aseteve të njejta në nivelin lokal, nacional dhe më gjërë*
- *Autenticiteti/Integriteti*

Deklarata e rëndësisë

Kështjella e Keqekollës është bartëse e vlerave specifike arkeologjike, kulturore dhe shoqërore për Komunën e Prishtinës dhe në Kosovë në përgjithësi. Si monument i trashëgimisë arkeologjike ku janë shtresuar qytetërime të antikitetit të vonë të shekujve IV – VI pas Krishtit, ajo ruan vlera të trashëgimisë lokale të gërshtuara me vlera të trashëgimisë së trevave fqinje të Gadishullit Ballkanik. Përfaqëson stilin e arkitekturës tipike të kohës së antikitetit të vonë.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit*
- *Përshkrimi i gjendjes teknike*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet tjera ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*

Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes së elementeve origjinale

.....

Përshkrimi i gjendjes teknike : Gjendja & konservimit i lokalitetit

Kështjella është në gjendje të keqe dhe në rrezik për dëmtime të mëtutjeshme në mungesë të ndërhyrjeve konservuese.

Faktorët ndikues ndaj asetit – nuk ka.

Faktorët natyror - Faktorët kryesor që dëmtojnë monumentin është e vegjetacioni i dendur në tërë sipërfaqen e kështjellës. Rreziqet nga dëmtimet natyrore janë të përhershme.

5. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I ASETIT/POLITIKA, MASAT JURIDIKE DHE TEKNIKE

- *Programet/Planet e promovimit, interpretimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së autenticitetit/integritetit të asetit, duke specifikuar nevojën dhe planet për ndërhyrje hulumtuese, riparimi urgjent, restaurimet dhe adaptimet për përdorim bashkëkohorë.*

- *Përdorimi i ndërtesës dhe shfrytëzuesit/pronari*
- *Statusi i asetit në relacion me legjislacion për planet e zhvillimit territorial dhe programet tjera zhvillimore.*
- *Relacioni i mbrojtjes së asetit me Planet ekzistuese zhvillimore të qytetit, fshatit, Komunës dhe Planin Hapsinorë të Kosovës.*
- *Sistemi i menaxhimi të asetit*
- *Resurset financiare vjetore në dispozicion apo të nevojshme*
- *Resurset profesionale në dispozicion dhe nevojat*
- *Kushtet për vizitor dhe statistikat*

Shtojcë4: *Projekt propozimet për punë hulumtuese dhe teknike, dhe Plani i menaxhimit të asetit*

6. MONITORIMI/INSPEKTIMI

- *Përshkrimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimi periodik i asetit, agjenda vjetore e inspektimit të asetit, mënyra dhe forma e raportimit me dokumentim*
- *Emërtimi i institucionit përgjegjës dhe kontak adresë*

7. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi, slajda dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershme mbi statusin ligjor të asetit.*
- ***Shtojcë 1***, *A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, formë të shtypur dhe digjitale.*
- ***Shtojcë 2***, *Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zones rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Planikadastral i asetit të propozuar për mbrojtje dhe zones rrethitje, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarë dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones rrethitje (buffer zone), në formë të shtypur dhe digjitale.*

- *Informatat gjeografike digjitale përkufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.*
- ***Shtojcë 3:*** *Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në $P=1:200$, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografika karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*
- ***Shtojcë 4:*** *Projekt propozimet për punë hulumtuese apo ndërhyrje teknike dhe Plani i menaxhimit të asetit të propozuar për mbrojtje.*

8. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: [Instituti Arkeologjik i Kosovës](#)

Hartuesi i formularit : [Haxhi Mehmetaj \(Arkeolog\)](#)

Adresa dhe kontakt: [Rruga Nazim Gafurri, p.n. 10000 Prishtinë](#)

Email : haxhim@yahoo.com

Mob. [044 122 204](#).

Data .../.../.....

Nënshkrimi





Kështjella e Keqekollës, muri perëndimor i Kullës



Kështjella e Keqekollës, kulla veriore e rrezikuar nga shembja



Kështjella e Keqekolles, muri rrethues ne anën perëndimore



Kështjella, hyrja në kullën veriore



Kështjella, hyrja kryesore në anënperëndimore



Kështjella, shkallaret në anën jugore të kullës